



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 34-të të KPF-së e mbajtur, më 09.09.2021, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Merita Bytyqi, DSH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se si duket kjo do të jetë mbledhja e fundit e KPF-s, unë ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pas, po ashtu atyre të cilët janë kandidat për asamble ju uroj suksese. Pastaj tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33 – të.
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2022-2024
3. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Caritasi-Zvicrran)

4. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Me qe vërejtje apo plotësime nuk pati kryesuesi e hodhi ne votim dhe me te gjitha votat prezentë 5 u konstatua se KPF-ja e kaloi rendin e ditës së propozuar!

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 5 vota

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 33-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim Vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2022-2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadani, , drejtor i DBF, I cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,tha se propozimet te cilat i kemi dhëne gjate dëgjimeve buxhetore nuk janë marr parasysh ose janë marre pjesërisht,. Po ndihna mire qe është hy propozimi im për çerdhe ne fshatin Shalë për vitin 2022, por nuk është e përfshinë qendra rinore ne Shalë. Po ashtu nuk e di pse nuk është përfshi puna e lapidarëve në këtë buxhet. Edhe unë kandidateve për asamble ju uroj suksese.

Albulena Kelmendi, unë personalisht nuk e kam analizua këtë propozim vendim, nuk e di as qëndrimin e grupit parlamentar, por unë do te votoj pro ketë propozimi. Edhe unë ju uroj suksese kandidateve për asamble komunale.

Afrim Miftari, ne si KPF kemi bërë një pune te mirë besoj dhe kemi kalu mire, temat te cilat i kemi ngrite kane qen ne te mire te qytetareve,ku shpesh here janë votuar edhe nga pozita edhe opozita. Edhe unë ju uroj suksese kandidateve për asamble. Kam një pyetje te shkolla te gradime a është përfshi ne këtë buxhet a jo?

Ukë Kryeziu, si duket kjo do te jete mbledhja e fundit e KPF-s, ne kemi kalu mire dhe jemi mundu me dhëne kontributin tone aq sa kemi mujte e kemi dite. Kandidateve për asamble edhe unë u uroj suksese.

Latif Ramadani, sa i përket shkollës ne Gadime, kemi pas pak telashe me çështjen e shpronësimit por do te kryhet, ndërsa sa i përket qendrës rinore në Shale e kemi mëndu qe te bëjmë te zyra e vendit aty ka vend. Ndërsa lapidaret nuk janë përfshi ne këtë buxhet.

Me qe diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin që të kaloj direkt në kuvend,me të gjitha vota prezentë për kaloi kjo pikë..

III

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Caritasi-Zvicrran)

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadanit , drejtor i DBF, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadanit , drejtor i DBF, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16,³⁵

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi